



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

V E N D I M

Nr. 90 datë 07.07.2014

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ GJYQTARIT GJIN GJONI

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e datës 07.07.2014, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjin Gjoni dhe marrjen ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, si dëgjoi pretendimet e gjyqtarit të proceduar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë,


V Ë R E N S E:

I. Mbi rrethanat e çështjes


1. Ministri i Drejtësisë, me shkresën nr. 3051/4 prot., datë 03.06.2014, “Kërkesë për procedim disiplinor” dhe me shkresën nr. 3051/7 prot., datë 24.06.2014, “Kërkesë për procedim disiplinor”, i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesat për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës Apelit Tiranë, Gjin Gjoni, njëkohësisht anëtar i KLD-së. Këto kërkesa për procedim, ka marrë shkas nga shkeljet që ka konstatuar Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave respektivisht me shkresën nr.2125 prot., datë 24.04.2014 dhe nr. 2798 datë 28.05.2014, drejtuar Ministrit të Drejtësisë.
2. Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara, Ministri i Drejtësisë, ka kërkuar bashkimin e të dy kërkesave për procedim disiplinor, dhe që ndaj gjyqtarit të lartpërmendur, të merret masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 33, pika 2, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në përputhje me nenin 31 të Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar. Në kërkesën për procedim citohet se janë konstatuar parregullsi në deklarimin e pasurisë nga ana e gjyqtarit Gjin Gjoni, në këto kushte subjekti i është nënshtruar kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ nga I.L.D.K.P.K.I.



3. Nga vlerësimi që i është bërë kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, dokumentacionit shkresor të administruar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Këshilli vlerëson se:
- i) shqyrtimi i kërkesave të paraqitur në këtë procedurë, nga pikëpamja formale dhe ajo procedurale është në kompetencën ligjore të KLD-së, në bazë të pikës “ç” të nenit 2 dhe neneve 31 e vijues të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.
 - ii) në referim të akteve shkresore, Ministri i Drejtësisë legjitimohet si nga pikëpamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 31 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe në nenin 34 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
 - iii) kërkesa e depozituar në KLD nga Ministri i Drejtësisë, është brënda afatit të parashikuar në nenin 34 të ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht nga data e kryerjes së shkeljes kanë kaluar më pak se 5 vjet dhe nga data e vënies në dijeni me shkeljen të Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor, ka kaluar më pak se 1(një) vit.
4. Në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, i ndryshuar, dhe të nenit 31 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, gjyqtari Gjini Gjoni është njoftuar për shkeljet e konstatuara, duke i vënë në dukje edhe të drejtën e paraqitjes së pretendimeve dhe provave mbi to, me shkresën nr.1964/1 prot., datë 04.06.2014 dhe me shkresën nr. 1964/4 prot., datë 25.06.2014.
5. Shqyrtimi i kërkesës për procedim ka qënë pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit datë 07.07.2014. Gjyqtari është vënë rregullisht në dijeni me shkresën nr. 2282 datë 03.07.2014 (për seancën e mbledhjes së KLD).
6. Rregullorja “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” në nenin 5 të saj parashikon se: “Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtarit i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit”. Gjyqtari i proceduar Gjini Gjoni, është njohur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë dhe me materialet e tjera të procedimit në adresë të tij, me shkresën nr. 1964/1 prot. datë 04.06.2014 dhe me shkresën 1964/4 prot., datë 25.06.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, provohet se i janë vënë në dispozicion:
- i) Kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor,
 - ii) Praktika materiale të procedimit dhe mendimi i gjyqtarit depozituar në Ministrinë e Drejtësisë.



7. Gjithashtu në nenin 6 po të Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”, parashikohet se: *“Gjyqtari ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën dyzetetë orë përpara fillimit të saj”*, gjyqtari Gjin Gjoni, është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, dhe konkretisht, me shkresën nr. 2282 datë 03.07.2014, gjyqtari është njoftuar për mbledhjen që do zhvillohej më datë 07.07.2014, në të cilën do të shqyrtohej kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj saj. Pra, më shumë se 48 orë para shqyrtimit të kërkesës është bërë njoftimi për mbledhjen e kësaj date.
8. Ky procedim disiplinor është në përputhje edhe me kriteret procedurale ligjore, sepse nga data e konstatimit të shkeljes prej Ministrit të Drejtësisë nuk ka kaluar ende 1 vit. Konkretisht, Ministri i Drejtësisë është njoftuar zyrtarisht për këto shkelje në datat 24.04.2014 dhe 28.05.2014, shkelje të cilat pretendohet se janë kryer nga gjyqtari Gjin Gjoni në vitin 2010.
9. Nga sa u parashtrua, rezulton se gjyqtarit Gjin Gjoni i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji dhe nga rregullorja, duke u zhvilluar në këtë mënyrë një proces i rregullt ligjor nga ana procedurale.
10. Në kërkesën e tij prezantuar më shkresën nr. 3051/4 prot., datë 03.06.2014, Ministri i Drejtësisë parashtron se:
 - 10.1 Bazuar në nenin 15 gërma b) të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar dhe nenit 45 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ku përcaktohet se shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga zyrtarët, përbëjnë shkelje disiplinore pavarësisht përgjegjësisë penale, sipas parashikimeve të nenit 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal, kemi konstatuar shkelje gjatë kontrollit të ushtruar për deklarimin e interesave private të subjektit Gjin Gjoni, me funksion gjyqtar, me qëllim marrjen e tyre në konsideratë nga Ministri i Drejtësisë.
 - 10.2 Për të vërtetuar saktësinë e pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, janë mbajtur korrespondenca me institucione publike dhe bankare, nga ku rezultojnë se ka pasuri të cilat nuk janë deklaruar nga ana e gjyqtarit në fjalë.
 - 10.3 Po kështu, nga analiza e të dhënave të grumbulluara ka rezultuar se, subjekti deklarues ka kryer transaksione financiare dhe nënshkruar marrëveshje e kontrata me persona të tretë, veprime të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se janë kryer me qëllim, për të ligjëruar burime krijimi fiktive, për të mbuluar pasuritë deklaruar nga subjektet dhe gjithashtu për të fshehur pasurinë në emër të personave të tretë.



Konkretisht për sa më sipër:

- i) Deklarim i rremë në lidhje me kontratën e dt.20.03.2007, për shitjen e 70% të kuotave të aksioneve të kapitalit të shoqërisë “ADFD” sh.p.k, të hartuar me dy vlera të ndryshme, 70.000 lekë dhe 300.000 Euro.
 - ii) Deklarim i rremë dhe mungesë burimesh financiare për kontratat e huasë me interes dhënë shtetasit Verner Mehlber në shumën totale 298.888 Euro (160.000 Euro + 138.888 Euro).
 - iii) Deklarim i rremë dhe burim financiar jo i ligjshëm për deklaratat për kthimin e huasë nga shtetasi Verner Mehlber në shumën totale 90.000 Euro principal (60.000 Euro + 30.000 Euro), dhe 37.908 Euro interesa (24.012 Euro + 13.896 Euro), gjithsej 127.908 euro.
 - iv) Fshehje dhe deklarim i rremë në lidhje me kontratën e sipërmarrjes dt.24.04.2012 të vilës rezidenciale në Farkë, në shumën 700.000 Euro.
 - v) Sipas kontratës së sipërmarrjes rezulton se në momentin e lidhjes së saj nga subjekti Gjini Gjoni dhe bashkëshortja është paguar kësti i parë prej 90.000 Euro.
 - vi) Fshehje në vitin 2012 e aktivitetit të shoqërisë “ALBCOS – Albanian Cosmetics”, ku shtetasja Elona Shpëtim Çausi figuron të jetë administratore dhe ortakë zotëruese e 100% të kuotave.
 - vii) Fshehje në vitin 2012 e aktivitetit të shoqërisë “Prestige Group, ku shtetasja Elona Shpëtim Çausi figuron të jetë ortakë zotëruese e 100% të kuotave.
 - viii) Fshehje në vitin 2010 e aktivitetit të shoqërisë “Terra Toscana Alimentari” ku subjekti dhe bashkëshortja Elona Çausi janë ortakë me nga 50%.
 - ix) Deklarim i rremë në lidhje me burimin e blerjes me kredi të automjetit tip Benz me vlerë 62.000 Euro në vitin 2010, pasi rezulton se në dt.20.04.2010 nga ana e subjektit i është likuiduar shoqërisë “Auto Star Albania” vlera totale e automjetit, ndërsa kontrata e kredisë me Landeslease sha. është lidhur në dt.23.04.2010, pra tre ditë më vonë.
 - x) Deklarim i rremë dhe mungesë burimesh financiare në lidhje me kontratën e blerjes dt. 29.12.2011 së apartamentit në Tiranë me vlerë gjithsej 53.200.000 lekë.
 - xi) Deklarim i rremë dhe mungesë burimesh financiare për apartamentin me vlerë 180.000 USD, viti 2010, i cili më pas deklarohet i shitur dhe shuma e mësipërme deklarohet si burim krijimi asetesh.
 - xii) Deklarim i rremë dhe mungesë burimesh financiare për shpenzimet e padeklaruara për 109 dhe 127 hyrje – daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, i subjektit Gjini Gjoni dhe bashkëshortes së tij.
11. Në kërkesën e tij prezantuar më shkresën shkresën nr. 3051/7 prot., datë 24.06.2014, Ministri i Drejtësisë parashtron se:

11.1 Bazuar në Kushtetutën e Republikës, në ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”, i



ndryshuar dhe ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, dhe në ligjin Ligjin nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”:

- i) Subjekti Gjini Gjoni ka shkelur hapur Kushtetutën, ligjin “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, që nga momenti kur është bërë aksioner aktiv në shoqëritë tregtare të sipërpërmendura.
- ii) Subjekti Gjini Gjoni, që nga data 14.10.2010 ushtron funksionin e gjyqtarit në papajtueshmëri me Kushtetutën dhe në konflikt të vazhdueshëm interesi.
- iii) Subjekti Gjini Gjoni, që nga data 04.06.2013 ushtron funksionin e anëtarit të KLD-së në konflikt të vazhdueshëm interesi”.


11.2 Nga korrespondenca me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit konfirmohet se subjekti Gjini Gjoni dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja Elona Çausi zotërojnë interesa private në 6 shoqëri, 3 nga të cilat ortakë themelues janë Gjini Gjoni dhe Elona Çausi, me nga 50% të kuotave të kapitalit.

11.3 Në kundërshtim të hapur me ndalimet dhe kufizimet e vendosura në Kushtetutë dhe dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjatë kohës që subjekti Gjini Gjoni ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, ka krijuar dhe regjistruar pranë QKR, veprimtari private si person juridik, duke qenë bashkëortakë themelues në shoqëri tregtare në 50% të pjesëve të kapitalit me shtetasen Elona Çausi.

11.4 Nga dokumentacioni i dërguar nga QKR, konstatohet se në vitin 2013 dhe 2014, subjekti Gjini Gjoni në shoqëritë tregtare, në të cilat ky subjekt është ortak me 50 % të pjesëve në kapital, ka kryer veprime tjetërsimi, për pjesën e kuotave në pronësinë e tij, në favor të bashkëshortes, personit të lidhur Elona Çausi, në 3 shoqëri ku kanë qenë bashkëortakë.

11.5 Në nenin 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet qartë: “*Qënia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private*”. Neni 22 i ligjit “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” thuhet: “*Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike*”. Në nenin 23 të ligjit “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet: “*Gjyqtarit i ndalohej edhe, të marrë pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi*”. Neni 33 të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ku përcaktohet “*.....Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme*”.

12. Ministria e Drejtësisë, nisur nga verifikimi dhe analiza e pretendimeve të parashtruara nga ana e gjyqtarit Gjini Gjoni dhe pas vlerësimit të observacionit të paraqitur prej tij, ka konkluduar se observacioni i tij ka qenë i pashoqëruar me asnjë prove shkresore provuese, se pretendimet e tij nuk janë të bazuara në fakte, prova e në ligj, për rrjedhojë dhe të papranueshme.



13. Nga analiza e të gjithë dokumentacionit të administruar në IJDKPKI, Ministri i Drejtësisë prezanton se lidhur me deklarinimin e interesave private të subjektit Gjin Gjoni ka rezultuar se gjyqtari Gjin Gjoni ka bërë fshehje apo deklarime të rreme në lidhje me burimin e blerjeve me shuma të mëdha që ai ka bërë, deklarinim i rremë dhe mungesë burimesh financiare për kontratat e huasë dhe të sipërmarrjes që ia ka lidhur si palë, si dhe deklarinim i rremë sa i përket aktiviteteve që ka patur në shoqëri private ku bashkëshortja e tij shtetasja Elona Shpëtim Çausi figuron të jetë ortakë.
14. Ministri i Drejtësisë çmon se gjyqtari Gjin Gjoni duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në përputhje me nenet 31 e vijues të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, dhe në përputhje me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji, janë shkelje shumë të rënda të disiplinës të parashikuara nga neni 32, pika 2, shkronja "ç" të këtij ligji, në të cilin parashikohet se:
"Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:
- ç) refuzimi për deklarinimin, mosdeklarinimi, fshehja ose deklarinimi i rremë i pasurive."*
15. Sikurse u parashtrua më sipër, për shkak të ndalimeve absolute dhe kufizimeve për të kryer veprimtari private nga njëra anë dhe posedimit të interesave private të ndaluara nga ana tjetër, subjekti Gjin Gjoni rezulton në:
- *Shkelje të hapur dhe të drejtpërdrejtë të Kushtetutës dhe të ligjit "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", në momentin e krijimit të këtyre shoqërive tregtare .*
 - *Për gjithë periudhën nga data 14.10.2010 dhe deri më sot ky zyrtar ushtron detyrën e gjyqtarit në papajtueshmëri të plotë, pikërisht për shkak të ushtrimit të aktiviteteve private të ndaluara nga Kushtetuta dhe ligji.*
16. Nga vlerësimi i këtyre fakteve, Ministri i Drejtësisë çmon se gjyqtari Gjin Gjoni duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në përputhje me nenet 31 e vijues të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32, pika 2, germet "a" dhe "gj" të këtij ligji.
17. Përfundimisht, për sa më sipër, Ministri i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë: "Procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjin Gjoni dhe marrjen e masës disiplinore ndaj tij "Shkarkim nga detyra". Gjin Gjoni duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në përputhje me nenet 31 e vijues të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji.



18. Në kundërshtim të pretendimeve të Ministrit të Drejtësisë, gjyqtari Gjini Gjoni argumentoi para Këshillit kundërshtitë e tij për procedimin disiplinor të paraqitur nga Ministri i Drejtësisë, kundërshtitë që konsistojnë kryesisht në:

- i) Ministri i Drejtësisë nuk ka kryer asnjë verifikim të materialit të ILDKPKI, asnjë hetim administrativ, ashtu siç është kërkesë e ligjit dhe në përfundim të të cilit të bëjë propozimin për procedimin disiplinor para Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por Ministri i Drejtësisë ka marrë “copy-paste” të materialit të ILDKPKI.
- ii) Materiali i përgatitur nga ILDKPKI nuk është serioz, aspak i bazuar në të vërteta apo në një analizë ligjore të drejtë të fakteve që kanë të bëjnë me deklarin e pasurisë, të burimeve financiare, si dhe për secilën konstatim të ILDKPKI është bërë argumenti nga ana e gjyqtarit.
- iii) Mosrespektimin nga Ministri i Drejtësisë i nenit 34, pika 2, i ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pasi fillimi i procedimit mund të bëhet jo më vonë se një vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që e ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se pesë vjet nga data e shkeljes. Të gjitha shkeljet e pretenduara nga ILDKPKI, edhe nëse do t’i marrim të mirëqëna janë jashtë afatit 5 vjeçar që kërkon ligji.

II. Mbi vlerësimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

19. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vlerëson se në kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit bazohet vetëm në shkresat nr.2125 prot., datë 24.04.2014 dhe nr. 2798 datë 28.05.2014, të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave drejtuar Ministrit të Drejtësisë. Kërkesat, të cilat nuk ka asnjë dokumentacion shoqëruar, që të pasqyrojë kryerjen e veprimeve të paligjshme nga gjyqtari, në mënyrë që organi procedures, në këtë rast Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë të iniciojë një inspektim të bazuar mbi fakte konkrete të cështjes. Për pasojë, në materialin e paraqitur në KLD, nuk ka asnjë provë të grumbulluar si rezultat i një verifikimi apo inspektimi, të cilat të provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, në referim të pikës 3 dhe 4 neni 31 I ligjit 8811 datë datë 17.05.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar.

“Neni 31

Procedimi disiplinor

3. Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe depoziton dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. Kërkesa për procedimin disiplinor, përveç dokumentacionit me të dhënat përkatëse, të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, përmban edhe propozimin për llojin e masës disiplinore që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit të proceduar disiplinorisht.

.....”.



20. Këshilli konstaton pamundësinë e tij për shkak të mungesës së dokumentacionit shoqërues për të konkluduar nëse veprimet e gjyqtarit të Gjykatës Apelit Tiranë përbëjnë shkelje të disiplinës nga ato të parashikuara në nenin 32 të ligjit 9877, datë 18.02.2008:

“Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:

ç) refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive.”

21. Këshilli në këto kushte, duke marrë në konsideratë edhe faktin se, në një rast tjetër analog, I.L.D.P.K.I. ka refuzuar zyrtarisht të vërë në dispozicion të Inspektoratit të KLD dokumentacionin e plotë provues për shkeljet e pretenduara ndaj një inspektori të KLD, me argumentin se dhënia e këtij dokumentacioni përbën shkelje të plotë të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe duke pasur në vëmendje detyrimin kushtetues për garantimin e një procesi të rregull ligjor të mbështetur në prova dhe fakte, ndaj kujtudo gjyqtari që procedohet, konstaton se është në pamundësi objektive të trajtimit pozitivisht të kërkesës së Ministrit të Drejtësisë.

22. Ky konstatim i Këshillit mbështetet dhe në vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës nr.214/61007-626 datë 27.05.2014, vendim i cili ka vendosur “Miratimin e vendimit nr.568 (13-2014-3046) datë 16.05.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (Për rrrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për caktimin e masës së sigurimit ndalues ndaj shtetasit Gjin Gjoni “Pezullimin e ushtrimit të detyrës”.

23. Në analizë të sa më sipër, Këshilli arrin në përfundimin se me dokumentacionin e paraqitur nga Ministri i Drejtësisë nuk provohet që gjyqtari Gjin Gjoni, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij gjyqësore, të ketë kryer veprimet e pretenduara, që të përbëjnë akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit deri në atë masë sa ndaj tij të merret masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”, dhe në këto kushte kërkesa nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë bazuar, në Ligjin nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin Ligjin nr.8811, datë 17.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar, si dhe në Rregulloren “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” miratuar me vendimin nr.137, datë 21.02.2003 i ndryshuar, duke qenë se Ministri i Drejtësisë nuk propozoi një masë tjetër disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjin Gjoni, sikundër parashikohet në Rregulloren “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” miratuar me Vendimin e KLD-së Nr.137, datë 21.02.2002, i ndryshuar,



VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjin Gjoni, dhe mbylljen e procedimit disiplinor të mëtejshëm ndaj gjyqtarit tij, për shkak se Ministri i Drejtësisë nuk propozoi një masë disiplinore tjetër.
2. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtarit.

U shpall sot, më datë 07.07.2014.

ZËVËNDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA

